

## Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin e Granades, Spanjë në kuadër të programit Erasmus +.

### Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025 në Universitetin e Granades, Spanjë.

### Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë të gjithë studentët e UMT-së, të cilët gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2024-2025 do të jenë në:

- Vitin e II, vitin e III, bachelor;
- Vitin e I, vitin e II Master;

### Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia ofrohet në gjuhën spanjolle (të gjitha programet) dhe në gjuhën angleze (disa prej programeve të studimit).

*Lëndët të cilat zhvillohen në universitetin pritës në semestrin e dytë i gjeni duke klikuar në linkun:*

https://ugrcat.ugr.es/en/

### Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (850 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

## Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Vërtetim dhe Listë notash e ciklit aktual të studimit (në gjuhën angleze);
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose e gjuhës spanjolle. Studentët që do të ndjekin studimet në gjuhën spanjolle duhet të disponojnë certifikatë të kësaj gjuhe. Studentët që do të ndjekin studimet në gjuhën angleze, duhet të disponojnë certifikatë të gjuhës angleze.  
Lidhur me certifikatat të cilat janë të njohura dhe pranon Universiteti i Granadës si edhe nivelin e kërkuar të gjuhës referohuni likut më poshtë:  
[http://internacional.ugr.es/pages/perfiles/estudiantes/ka107\\_2017\\_attachment\\_1\\_language\\_requirements\\_ugr](http://internacional.ugr.es/pages/perfiles/estudiantes/ka107_2017_attachment_1_language_requirements_ugr)  
Kandidatët të cilët janë në proces të marrjes së certifikatës të gjuhës janë të lutur të dorëzojnë provën e regjistrimit. *Universiteti i Granadës ofron mundësinë që studentët të mbrojnë gjuhën spanjolle dhe të përfitojnë certifikatë përmes testit eLADE. Për më shumë referohuni linkut: <https://www.clm-granada.com/elade/index-en.html>*
- Dokumenti Learning Agreement\*

\* *Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Granadës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.*

Për më shumë informacion mbi programin e studimit të ofruar nga Universiteti i Granadës vizitoni:

<https://internacional.ugr.es/pages/perfiles/estudiantes/incoming-erasmus-dimension-internacional?lang=en>

Afati për aplikim: **5 Shtator, 2024**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën [iro-projects@umt.edu.al](mailto:iro-projects@umt.edu.al) ose dorazi në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

***UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!***